D R A M Ë

ADEM JASHARI DHE VDEKJA

- KADRUSH RADOGOSHI -

*** * ***

Të gjithë atyre që flijuan jetën për lirinë e Kosovës, në shenjë respekti dhe nderimi të përjetshëm. **Autori**

Përralla për krimin

- U nis shpejt e shpejt për të arritur në Tempullin e Talisë, ku ishin mbledhur të gjithë baballarët e teorive të dramës, në seancën e rregullt të parlamentit të tyre.

- Rreptësisht ndalohet hyrja për ty! - i tha portieri.
- Ma lësho rrugën! - i tha.
- Thyej qafën! Ik! Mos t'i shoh sytë! - e kërcënoi.
- Po nuk më hape rrugë, të vras!

Portieri i tregoi rrugën e kthimit me gisht.

Duke qenë njeri që nuk kthehet prapa, e vrau.

Pastaj hyri në Sallën e Madhe.

Të gjithë e përbuzën, e përzunë, deshën ta burgosnin.

S'pati rrugë tjetër, pos t'i vriste të gjithë.

Para kufomave të parlamentarëve tha: "Këtë seancë do ta udhëheq unë, ish-poeti i shndërruar në vrasës".

PERSONAZHET:

- ADEM JASHARI
- HAMËZ JASHARI
- SHABAN JASHARI
- ORAKULLI I DARDANISË
- VDEKJA I
- VDEKJA II
- VDEKJA E BUKUR
- FEHMI LLADROVCI
- XHEVA
- ILIAZ KODRA
- BEKIM BERISHA

Prologu

ORAKULLI I DARDANISË:
Nga cilado pikë e Globit
nuk është larg të shkohet në Prekaz
Mjafton ta kalosh
kufirin në mes jetës e vdekjes
do të jesh aty
ballë për ballë
me mbijetesën.
Në Prekaz
edhe qielli me yje
të varura mbi lisa
edhe kodrat e mbuluara me plisa
recitojnë të vetmet fjalë:
Duart e përgjakura
nuk i lan shiu
as i harresës as i pendesës!
Nëse mbetesh në udhëkryq
pyete Anteun
Prometeun pyete
të dy flasin shqip...
Pastaj
rrugën duhet ta bësh më këmbë
dhe s'dihet sa zgjat
sa një fluturim shqiponje
apo mija e mija vjet…

Sido që të jetë
ia vlen të nisesh
edhe nëse nuk arrin kurrë
në vendlindjen e përjetësisë…

AKTI I PARË

ADEMI: Në ëndrra më mbiu pema e lirisë
kur u rrit e filloi të japë fruta
e pashë se ishte e huaja...
E jona ishte vetëm ëndrra…
HAMZA: Nuk e di a është Atdheu nënë e Lirisë!
Nuk e di a është Liria nënë e Atdheut!
Nuk e di në Atdheu i ka mbyllur dyert Lirisë
apo Liria Atdheut!
ADEMI: Sidoqë të jetë
fusha e errët e robërisë
shtrihet para syve tanë
e gjerë dhe e trishtë...
HAMZA: Po u bëre dritë në mes të errësirës
Do të jesh fillikat vetëm
i uritur do të jesh
e s'do të mund të thithësh
nga gjinjtë e natës…
ADEMI: Po u bëre drite në mes të errësirës
rrënjët do t'i lëshosh
thellë-thellë në dashuri
zjarr do të jesh…
SHABANI: Po u bëtë dritë në mes të errësirës
do të jeni lindje
foshnja lirie do të jeni…
HAMZA: Historia jonë qenka një ndjekje
deri në pafundësi
një përpjekje për të na ulur
në karrigen e harresës
një zëvendësim i heronjve
me gënjeshtarë, frikacakë e smirëzez
të mbuluar me lavdi
që s'e meriton askush
nga ata që vetëm dinë

të pëgërin e të përmjerrin
në këtë botë...
ADEMI: Herë ta rrëmbejnë haptas
herë tinëzisht ta vjedhin
të drejtën me pasë Atdhe!
HAMZA: Sa tmerr
të jetosh
në atdheun e vjedhur
apo të rrëmbyer publikisht!
SHABANI: Bijtë e mi,
po jua them poezinë, të cilën isha duke ua thënë nxënësve të mi, këtu e dyzet vjet më parë, kur erdhën e m'i vunë prangat para tyre, në klasë, e nuk më lanë, kurrë më, ta marr ditarin që aq shumë e kamë dashur:
ZJARRI I PROMETEUT
Në qerren diellore e ndezi pishtarin
Secilin e bëri ta shikojë yllin e vet
në qiellin e jetës së pajetuar...
E zbriti pishtarin e ndezur
në terrin e jetës njerëzore
njerëzit i panë lulet e çelura
fushat e bleruara të gëzimit
i njohën sërish.
Pishtari i ndezur në qerren diellore
e solli pranverën e jetës
këtë flutur të bukur
asnjëherë të zënë lehtë
këtë këngë shpeshhere të shndërruar
në jehonë.
Për t'u ngrohur shpirtin
e mbuluar mardhe
zjarrin e shenjtë u solli
dhe nuk u ankua në asnjë gjykatë
për gozhdimin në gurin e tmerrit...
ADEMI: E kam parë me sytë e mi
kur e vranë shikimin
në sytë e asaj vajze
së pagëzuar Liri
në sytë e atij djali

të pagëzuar Çlirim...
HAMZA: Me sytë e mi e kam parë
kur i këputën dorën
flokëkaçurrelit me sy të gjelbër
kur pikturonte Diellin e Madh
mbi qiellin e Kosovës...
ADEMI: Me këta dy sy e kam parë
skenën më tragjike të teatrit absurd
të lozur nën qiellin e hapur
të Drenicës, Dukagjinit e tërë Kosovës...
ku shkëlqejnë mija yje
që vriten për çdo çast
për të lindur më të mëdhenj
të nesërmen e kësaj skene
të reprizuar për herë të fundit…
SHABANI: E kamë parë me sytë e mi
fluturimin e pandalshëm të Shqiponjës
ndonëse kishte plagë në krahë
e quhej Ahmet Delia
ndonëse kishte plagë në gjoks
e quhej Azem Galica
ndonëse kishte plagë në kokë
e quhej Tahir Mehaj
tek betohej në tokë e qiell
tek shndërrohej në yje e diell
e kam parë, pasha këta sy!
HAMZA: A ju kujtohen sytë e kaltër si deti
të vënë në majën e kamave të ndryshkuara?
ADEMI: A ju kujtohen sytë e blertë
si fushat e Kosovës
që mund t'i keni parë
nëpër kalldrëmin e Rrugës Egnatia?
SHABANI: A ju kujtohen sytë e zez
si ullinjtë shqiptarë
të shkelur nga dinozaurët e hekurt?
HAMZA: Me këta dy sy e kam parë
Mësuesin tim të parë
varur në shtyllë elektrike

ADEMI: Dorën e djathtë ia kishin këputur
me të cilën na pati shkruar
për herë të parë
shkronjën A – Atdheu.
HAMZA: Skronjën L - Liria
SHABANI: Në kohën kur atdheu ishte dashuri ilegale
kur liria ishte mollë e ndaluar...
HAMZA: E kanë parë edhe zogjtë në qiell
e edhe lisat e malit e kanë parë...
SHABANI: Edhe foshnjat e djepit
e ato që ende gjenden në bark të nënës...
ADEMI: E kam parë... E kam parë...
HAMZA: Kush po zbret nga Qyqavica,
nuk është Shota as Azem Galica!...
ADEMI: Flokëthinjur e mjekërbardhë
për te ne është nisë me ardhë…
SHABANI: Mirë se erdhe, Orakull i Dardanisë!
Nga je nisur unë e di,
po s'e di ku do me m'rri.
ORAKULLI I DARDANISË: Jam nisur nga Vendenisi, kam vazhduar nëpër Ulpianë, Therandë e Dukagjin për të ardhur këtu tek ju.
ADEMI: Kë takove në Dukagjin?
ORKULLI I DARDANISË: Takova nipat e Lekë Dukagjinit.
HAMZA: Gjuhën tënde të lashtë a e kuptuan?
ORKULLI I DARDANISË: Gjuhën e lashtë të flijimit e kishin mësuar mirë!
ADEMI: Kush ishte me ta?
ORKULLI I DARDANISË: Djemtë më të mirë të Gjakovës e të Pejës me vete i kanë. Edhe lisat më të lartë, të cilët nuk do të ngriteshin aq lart për ta puthur qiellin, po të ishin frikësuar nga rrufetë, me vete i kanë.
SHABANI: Ku do të përfundosh udhëtimin, Orkull i Dardanisë?
ORAKULLI I DARDANISË: Këtu do të qëndroj së bashku me ju, në zemrën e Dardanisë, në Drenicë, në Prekaz.
SHABANI: Cila është profecia?
ORAKULLI I DARDANISË: Kur ta mbjellësh lulen e parë
në kopshtin e lirisë
Dardania do të trandet

e nga gjumi i rëndë do të zgjohet…
Dielli i lirisë do të buzëqeshë
në skaj të horizontit
e rrezen e parë do ta lëshojë
mbi gjymtyrët e ngrira
të atdheut…
SHABANI: Mos u ndal pa e përfunduar profecinë!
ORAKULLI I DARDANISË: Barrë të rëndë do ë bartësh në shpinë, o bir!
SHABANI: Vazhdo profecinë, hirësi!
ORAKULLI I DARDANISË: Kur ta mbjellësh trëndafilin e dytë
do të thuash:
lirinë e dua më shumë se Ademin.
Kur ta mbjellësh trëndafilin e tretë
Hamzën
do të thuash
liria nuk vjen
pa e kaluar rrugën e dhembjes
nëpër të cilën ecin
vetëm Prometetë...
SHABANI: Hirësi, heshte për të pushuar, apo mos po frikësohesh se nuk do ta pranoj profecinë, barra e së cilës është e rëndë?
ORAKULLI I DARDANISË: Nuk dyshoj në guximin tënd dhe të djemve të tu, o Shaban Jashari. S'kam dyshuar as në Shabanin tjetër para teje.
SHABANI: Përfundoje profecinë, Hirësi!
ORAKULLI I DARDANISË: Kur ta mbjellësh veten
vetë të katërdhjetëetetin
në kopshtin e lirisë
lulja e kushtrimit do të rritet
sa çelemshel sytë
e me petale do ta mbulojë dhenë
ku po rritet bimë e lirisë...

AKTI I DYTË

VDEKJA I: Erdha te ti, o Adem Jashari.
ADEMI: Pse erdhe?
VDEKJA I: Të të tregoj se të njoh.
ADEMI: Ti më njeh?

VDEKJA I: Po, të njoh.
ADEMI: Qysh kur?
VDEKJA I: Që kur erdhe në këtë botë.
ADEMI: E kur paskam ardhur në këtë botë?
VDEKJA I: Në këtë botë ke ardhur më 28 nëntor 1955
ADEMI: Shqiptimi i një dite dhe një muaji të caktuar dhe një viti gjithashtu të caktuar s'do të thotë asgjë.
VDEKJA I: Si mund të thuash kështu?
ADEMI: Thjesht, drejt !
VDEKJA I: Thjesht? Drejt?
ADEMI: Po!
VDEKJA I: Njeri i çuditshëm!
ADEMI: Aspak!
VDEKJA I: Nëse s'je i çuditshëm, atëherë s'mund të jesh tjetër pos rebel.
ADEMI: Unë, rebel?
VDEKJA I: Po, pikërisht ti, Adem Shaban Jashari.
ADEMI: Ma ditëke edhe emrin e babait !
VDEKJA I: Kuptohet.
ADEMI: Pasha tokën e pasha qiellin
pasha yjet e pasha diellin
pasha tokën e Drenicës
pasha kryet e Azem Galicës
nuk jam i tillë.
VDEKJA I: Po, ti nuk po pranon asnjë mendim timin.
ADEMI: Çdo mendim të vlefshëm e pranoj.
VDEKJA I: Ti nuk pranon llogaritjen e kohës! Nuk i pranon rregullat e kësaj llogaritjeje!
ADEMI: Unë llogaris kohën dhe respektoj rregullat e saj.
VDEKJA I: Si?
ADEMI: Thjesht!
VDEKJA I: Cila na qenka thjështësia jote?
ADEMI: Pikë fillese gjithmonë është kalimi i një heroi të kësaj toke dhe të këtij qielli në përjetësi!
VDEKJA I: S'po kuptoj!
ADEMI: Mendjetrashët nuk kuptojnë!
VDEKJA I: Vetëm mendjetrashët?

ADEMI: Edhe qyqarët, që dinë ta vënë shpesh maskën e heroit dhe i shijojnë frutat e të qenit idhull i qyqarëve.
VDEKJA I: Po, unë nuk jam e tillë!
ADEMI: Ti je mbretëresha e tyre.
VDEKJA I: Mirë, mirë, të mos largohemi nga tema!
ADEMI: Unë nuk i frikësohem asnjë teme, prandaj as temav të tua. S'kam ndonjë arsye për të ikur qoftë edhe nga tema jote.
VDEKJA I: Ishim te matja e kohës, te rregullat e saj dhe te kalendari evropian, të cilat ti nuk i respekton.
ADEMI: Kush të tha se nuk e pranoj llogaritjen e kohës sipas rregullave evropiane?
VDEKJA I: Në njëfarë forme, e the.
ADEMI: S'është e vërtetë!
VDEKJA I: Po ti, nuk e more si pikë fillese për llogaritjen e kohës lindjen e Jezusit, që shënon fundin e erës së vjetër dhe fillimin e erës së re.
ADEMI: Po me asgjë nuk e kundërshtova !
VDEKJA I: Të përmendësh heronj të tjerë si pika fillese dhe të sugjerosh ringjallje tjetër, është herzi, është mohim.
ADEMI: Po të mbetej vetëm me një hero, siç thua ti, bota do të bëhej shumë qyqare, do të mbushej me qaramanë e qyrrashë, do ta mbulonte myku e athëtia...
VDEKJA I: A ke më, o Adem Shaban Jashari?
ADEMI: Njerëzit s'do të kishin hapësirën e domosdoshme për jetë, do t'u zihej fryma.
VDEKJA I: Njeriu është krijuar për t'iu përshtatur rrethanave. Ata që s 'mund t'iu përshtaten rrethanave ose vijnë vullnetarisht tek unë, ose unë e zgjas dorën time shpëtimtare.
ADEMI: Njeriu është krijuar për t'i kundërshtuar rrethanat ekzistues, për t'i ndryshuar, për t'i përmirësuar dhe për ta krijuar hapësirën për jetë të denjë.
VDEKJA I: Rrethanat i ndryshon tjetërkush.
ADEMI: Ato i ndryshojnë njerëzit syshkëndijë e me lulen e kuqe në mesin e ballit.
VDEKJA I: Lulja e kuqe është e komunistëve.
ADEMI: Eshtë jona që nga krijimi i botës dhe e tillë do të mbetet, deshe apo nuk deshe ti dhe tërë pjella jote e zezë.
VDEKJA I: Mirë! Mirë! Të kthehemi te Pika e Fillesës !

ADEMI: Te Pikat e Fillesës !
VDEKJA I: Ja, këtij qëndrimi i thonë rebelim, i thonë ngritje krye kundër rendit absulut të vlerave!
ADEMI: Çdo gjë është relative në këtë botë, prandaj edhe çdo rend vlerash i tillë është.
VDEKJA I: Evropa ka vetëm një Pikë Fillese!
ADEMI: Kjo është e vërteta jote e absolutizuar, e cila vazhdimisht ka gjuajtur me të gjitha llojet e armëve, të dukshme e të padukshme, për t'i vrarë të vërtetat e tjera.
VDEKJA: Ku na qenkan ato farë të vërtetash të tjera?
ADEMI: Ato gjenden kudo, por dikush i sheh, sepse ka sy për t'i parë dhe veshë për t'i dëgjuar, ndërsa të tjerët nuk i shohin, sepse nuk kanë sy, dhe nuk i dëgjojnë, sepse nuk kanë veshë. Ka edhe të atillë, që as nuk duan t'i shohin të vërtetat, as nuk duan t'i dëgjojnë, bile mundohen t'ua mbulojnë të tjerëve për të mos i parë dhe t'i heshtin apo t'i mbulojnë me plafin e zhurmave të reja, të cilat mundohen t'i shesin për vlera të reja.
VDEKJA I: Këtë prirje për të tjerrë mendimet sigurisht e ke trashëguar nga babai yt, nga mësuesi i rebeluar dhe pastaj i burgosur, Shaban Murat Jashari, apo ndoshta nga këngët kushtuar njerëzve të rebeluar, kënduar nga vëllai yt, Hamza.
ADEMI: Gjëja e parë dhe më e rëndësishme, që kam mësuar nga babai im, nga vëllai Hamza, nga bulëzimi i pemëve e çelja e luleve, nga rrezitja e diellit ditën e ndriçimi i yjeve natën, nga puhia e erës dhe fluturimi i fluturave, nga ngjyrat e ylberit të reflektuara në sytë e vajzave të dashuruara, ka qenë të të urrej ty, o vdekje e shëmtuar.
VDEKJA I: Edhe ti do të jesh i nënshtruari i dorës sime të gjatë.
ADEMI: Kurrë!
VDEKJA I: Mos e harro Pikën e Fillesës!
ADEMI: Populli im ka shumë Pika të Fillesës dhe të gjitha kanë të njëjtën domethënie.
VDEKJA: Herezia s'ka brirë!
ADEMI: Mbase edhe mund të ketë !
VDEKJA I: Cili na qenka mesazhi i Pikave të tua të Fillesës?
ADEMI: I thjeshtë fare: koha ka nxjerrë njerëz të mëdhenj, të cilëve u kanë dhënë emër dhe këta bij të denjë të kohës i kanë dhënë asaj emrin e tyre.
VDEKJA I: Cilët na qenkan ata?

ADEMI: I di mirë ti se cilët janë dhe asnjëri prej tyre me jetën dhe veprën e vet nuk e kanë mohuar as lindjen e Jezusit e as idealet për të cilat ai u flijua, përkundrazi janë flijuar për të dëshmuar se njerëzit lindin të barabartë dhe duhet të jetojnë të barabartë, apo thënë edhe më troç ata lindin të lirë, prandaj edhe duhet të jetojnë të lirë, bile të lirë edhe të vdesin.
VDEKJA I: Po më bind gjithnjë e më shumë se ke hyrë thellë në rrugën e rebelimit tënd, qoftë edhe kundër meje, mbretëreshës absolute të kësaj bote.
ADEMI: Unë nuk jam prej atyre që e njohin vetëm një vdekje.
VDEKJA I: Si? Si?
ADEMI: Ti nuk je e vetmja vdekje. Vdekje ka shumë. Mjer ai që nuk e di këtë gjë !
VDEKJA I: Cilat na qenkan ato vdekje?
ADEMI: Vdekjet janë si femrat. Mund të jenë të shëmtuara e të liga sikur ti, po mund të jenë të bukura e fisnike sa të dashurohesh në to dhe prej më të bukurave mund ta zgjedhësh njërën dhe ta dashurosh e ta mbrosh, duke e mbajtur me vete kudo që të shkosh.
VDEKJA I: Unë kam marrë nga kjo botë e do të marr njerëz trima, që kanë shumë ithtarë, të cilët zakonisht i marr së bashku me të adhuruarin e tyre.
ADEMI: E di që i ke marrë me rrojë e me skojë qyqarët e tillë.
VDEKJA I: Edhe ty do të të marr me dorën time të gjatë.
ADEMI: Dora jote nuk është aq e gjatë sa për arritur tek unë.
VDEKJA I: Dora ime është aq e gjatë sa mund të arrijë tërë familjen tënde dhe ty në mesin e saj. Nëse do edhe tërë Prekazin mund ta arrijë.
ADEMI: Ik, deri sa s'të kam vrarë!
VDEKJA I: Mua s'më vret pushka as topi.
ADEMI: Ty, jo vetëm që të vret pushka e topi, po edhe dora ime thatë, kur ta dredhë qafën e ta këputë si të ishe skërrajë e dalë pas shiut.
VDEKJA I: Ha-ha, ha-ha-ha….
ADEMI: Këtu je mysafire e paftuar. Ti je vdekje në jetë apo jetë në vdekje? Cilado që je, qofsh e mallkuar!
VDEKJA I: Kot më mallkon. Ti duhet të udhëtosh nga ky vend i mallkuar.
ADEMI: Unë të udhëtoj?
VDEKJA I: Po, ti duhet të largohesh nga Prekazi.
ADEMI: Nga Prekazi?

VDEKJA I: Pikërisht nga Prekazi dhe të mos marrësh asgjë me vete, bile edhe kujtimet për të dhe çdo gjë të tij t'i hedhësh në humnerën e thellë të Mbretërisë së Harresës.
ADEMI: A ke më për të thënë?
VDEKJA I: Po veprove sipas këshillave të mia, do ta shpëtosh kokën.
ADEMI: Grua e përdalme ! Shtrigë e çalë! Hijenë me shalë!
VDEKJA I: Mos u ngut, Adem, të lutem, jo pse tutem apo ngutem, po për ty dua të lutem në altarin e Tanatosit.
ADEMI: Ti, të lutesh për mua!?
VDEKJA I: Të lutem, për të të pranuar në botën e pendesës.
ADEMI: çdo herë jam nisur nga Prekazi për të shkuar diku, qoftë edhe në fundin e shtatë botërave, përsëri kam arritur në Prekaz.
VDEKJA I: Si është e mundur?
ADEMI: Të habit ky fakt?
VDEKJA I: Je njeri i patakt!
ADEMI: Ç'më duhet takti jot?!
VDEKJA I: As mua fakti jot!
ADEMI: Pasha simfoninë e erës,
Pasha lulet e pranverës,
Pasha bjeshkët e larta,
Këtu e ëmbël është edhe balta...
VDEKJA I: Unë po nisem me polici!
ADEMI: Pasha tokë e pasha qiell
Për këto yje e për këtë diell
Nuk më frikëson polici barbare
As ti vdekje me fytyrë qyqare…
VDEKJA I: S'jam qyqare, po unë të korri
Në dash në fund, në dash në krye oborri…
ADEMI: Më vjen të qesh e të tallem
Po në këngë më shumë çmallem...
VDEKJA I: Unë kam ardhur të të arrestoj e pastaj të të gjykoj në bazë të ligjeve të mbretërisë sime të nëntokës...
ADEMI: Po të ndërpres, o zonjë e zezë! Po ç'kërkon ti në këtë botë? A e di se mund të të vras, të të godas e në humnerë të të përplas?
VDEKJA I: Hi-hi-hi...
ADEMI: S'të duroj, oj orrospi, që në shtëpinë time do me hy!
(Shfaqet Shaban Jashari e Hamza dhe që të tre gjuajnë me pushkë, Vdekja Qyqare shtrihet përtokë).

AKTI I TRETË

VDEKJA II: Të dashuruarit në të ashtuquajturën liri ose janë të vdekur ose janë në burg apo larg vendlindjes. A s'po të mbyt vetmia, o Adem Jashari?

ADEMI: Unë nuk jamë vetëm?

VDEKJA II: E di! Ke familjen tënde! Ke babanë! Ke vëlla Hamzën!

ADEMI: Jo vëllanë, po vëllezërit!

VDEKJA II: Po mirë, vëllezërit, po megjithatë Rifatin s'e ke këtu!Në mes teje e atij ekzistojnë kufij! Ekziston një largësi!

ADEMI: Kufijtë i kanë vënë të ligjtë për t'i ndarë njerëzit, vëllezërit!

VDEKJA II: Megjithatë, ata qëndrojnë kërcënueshëm para të gjithë atyre që nuk i respektojnë.

ADEMI: Të parën gjë që kamë mësuar, kur kam ardhur në këtë botë, ka qenë mospranimi i kufijve dhe nevoja e përhershme për rrënimin e tyre. Njerëzit, duhet të jenë të lirë të shkojnë ku të duan, ashtu si zogjtë, që fluturojnë nëpër qiellin e paanë.

VDEKJA II: Po e vazhdoj aty ku e lashë për shkak të ndërhyrjes sate.

ADEMI: Vazhdo prej ku të duash!

VDEKJA II: Ke gruan, fëmijët, nipat e mbesat. Pra, je vetëm me familjen tënde e kjo do të thotë se je vetëm, për të mos thënë qyqelume vetëm.

ADEMI: Edhe vetëm një lis, nëse është i blertë, me mua është. Edhe vetëm një gur në bjeshkët e Kosovës, nëse është i palëkundur nga vendi, me mua është. Edhe vetëm një zog, nëse fluturon, me mua është. Edhe vetëm një yll, nëse në qiell ndriçon, me mua është. Edhe vetëm një krua, nëse rrjedh ujë të kulluar, me mua është. Edhe ajo shqiponjë, që po fluturon me aq krenari dhe nuk po e çan kokën për retë e dendura,që po dynden në këtë qiell, me mua është. Edhe vetëm një…

VDEKJA II: Sa i marrë që je! Vetëm qilimi fluturues po të munguaka!

ADEMI: Atë ta kam lënë ty.sepse të duhet për të hipur dhe për ta thyer qafën tënde.

VDEKJA II: Po mundohesh ta bësh shumë trime jetën, e jeta e trimëruar të vret.

ADEMI: Vrasje e bukur! Vrasje e dashur!

VDEKJA: Po mundohesh ta bësh shumë të mençur jetën. Jeta e stërngarkuar me mençuri të shpie më së lehti në çmendi.

ADEMI: Nëse nga mençuria mund të shkohet në çmendi,

Kjo s’është e thënë të ndodhë me siguri!
Po nga marria, nga ajo që thua ti,
A ka rrugë për në mençuri
Apo
në ishullin e adhuruar?
VDEKJA II: Edhe mund të ketë,
nëse bie në rrjetë
e të merr gjumi përjetë!
ADEMI: Do t’i thyej muret e ndërtesës sate për të vendosur dritare nëpër të cilat do të hyjnë rrezet e diellit të dashurisë, ndërsa engjëjt e qiellit të kaltër e të erës së ngrohtë pranverore do ta bekojnë jetën.
VDEKJA II: Ti, rebelohesh kundër meje! Rebelohesh kundër ligjeve të shenjta të pushtetit qiellor, prandaj do të dënohesh rëndë!
ADEMI: E ç’ka na qenka ai dënim i rëndë?
VDEKJA II: Dënime ka shumë dhe ato janë të rënda. Secili më i rëndë se tjetri është!
ADEMI: Frika është lavire dhe meriton të përbuzet!
VDEKJA II: Ai që e di fatin e Prometeut, i cili përkundër dëshirës së zotërave e mori zjarrin e shenjtë, duke e ndezur pishtarin e tij në Qerren e Zotit Diell dhe duke ua dhuruar njerëzve, duhet të ndalet e të mendojë.
ADEMI: Ç’farë të mendojë?
VDEKJA II: Për dënimin dhe vuajtjen e pafund!
ADEMI: Megjithatë, Prometeu e mbijetoi vuajtjen!
VDEKJA II: Zeusi e lidhi me hekura për një shkëmb të Kaukazit, ku shpendi grabitçar për çdo ditë i hante mëlqinë, e cila i rritej gjatë natës, por të nesërmen shpendi grabitçar vazhdonte të njëjtën gjë. Dhembjes dhe mundimit nuk i gjendej fundi.
ADEMI: Megjithatë, Prometeu, ashtu si populli i Dardanisë sime, arriti ta mbijetojë dhembjen dhe mundimin e rëndë.
VDEKJA II: Nëse Prometeu arriti të mbijetojë, Eskulapi nuk arriti një gjë të tillë dhe pikërisht ky ishte një nga paraardhësit e tu të lashtë, të cilin e mora nga kjo botë me këto duar.
ADEMI: S’po ma mbushin synë duart e tua!
VDEKJA II: Kështu pati menduar edhe Eskulapi, i cili duke qenë mjeku më i mirë që kishte njohur kjo botë, e theu rendin hyjnor. Ai m’i merrte njerëzit nga duart, duke i shëruar nga goditjet e dukshme e

të padukshme të shigjetës sime. Ai nuk u ndal me kaq, por filloi t'i ngjallte të vdekurit.
ADEMI: Ka ngjallur të vdekurit?
VDEKJA II: Ngjalli Likurgun, Tindarin, Kapaneun, Glaukun dhe Hipolitin
e Bukur.
ADEMI: Pse s'thua edhe të pafajshëm?
VDEKJA II: S'është me rëndësi fakti në ishte apo s'ishte fajtor Hipoliti, kur e zbatova dënimin, duke e zgjatur dorën dhe duke e dërguar në mbretërinë time.
ADEMI: Eskulapi paska korrigjuar një padrejtësi!
VDEKJA II: Ajo që ti quan korrigjim padrejtësie s'është gjë tjetër, pos thyerje e rendit hyjnor.
ADEMI: Rendi hyjnor qëndruaka me këmbë në padrejtësi e padrejtësia duhet të luftohet !
VDEKJA II: Të mençurit luftojnë për ta fituar të mundshmen!
ADEMI: Trimat luftojnë për ta fituar atë që duket e pamundshme, prandaj i tërheq rreziku dhe janë të rrallë.
VDEKJA II: Edhe Eskulapi ishte i rrallë, por dora ime e shndërruar në rrufe të Zeusit e goditi e pastaj e mori me vete.
ADEMI: Rendi hyjnor, i krijuar nga perenditë hakmarrëse, ka ndëshkuar me rrufe jo vetëm Eskulapin, po edhe popuj të tërë.
VDEKJA II: S'po të kuptoj mirë!
ADEMI: Më mirë thuaj s'po dua të të kuptoj!
VDEKJA II: Mos po do të thuash se edhe popullin tënd e kam goditur shpeshherë pa faj?
ADEMI: Pikërisht këtë desha të ta them!
VDEKJA II: Qysh në Trojë ngritët krye kundër meje, prandaj unë ju godita vazhdimisht!
ADEMI: Dhe, ne të luftuam me të gjitha mjetet për të mbijetuar, për ta mbrojtur të dashurën tonë - jetën, në këtë tokë dhe nën këtë qiell.
VDEKJA II: Ti përmend pjesën tënde të qiellit, po ligjet e tërësisë së tij s'i përfill.
ADEMI: Nuk i respektoj vetëm të shpifurat. Unë jetoj në tokë, në Prekaz. Këtu vlejnë ligjet e tokës së Drenicës…
VDEKJA II: Megjithatë, toka qeveriset me ligjet e qiellit dhe kjo është një e vërtetë absolute.

ADEMI: Qielli dhe toka nuk janë në armiqësi. Toka e do qiellin, jo vetëm kur është i shëndetshëm dhe e mbulon me vellon e kaltër, por edhe kur është i sëmurë e gjëmon nga dhembjet e më shumë nga shqetësimet për të gjitha marritë që e mundojnë tokën. Edhe qielli e do tokën qoftë ditën, kur rrezet e arta të diellit ia dhuron, qoftë natën, kur shndërrohet në kësulë magjike të stolisur me miliona yje dhe vendoset në kokën e Tokës Princeshë të kredhur në ëndrrën e saj të purpurt.
VDEKJA II: Romantika është e njerëzve të paditur dhe kokëkrisur…
ADEMI: Të dashuruarve në bukuroshen e quajtur Liri u ka hije romantika dhe ky lloj i romantikës ua çel sytë, ua rrit guximin për t'u ndeshur me bishën shumëkrerëshe të robërisë.
VDEKJA II: Mos do të thuash se njerëzit po mardhin nga acari i robërisë?
ADEMI: Ata po dridhen nga të ftohtët e disa edhe nga frika...
VDEKJA II: …dhe ç'do të bëjë shkelqësia juaj për ta?
ADEMI: Nëse ka nevojë t'i ngroh me zjarrin e shpirtit e të trupit tim, të baba Shabanit, të vëlla Hamzës, të nënë Zahides, të gruas, kunatave, nipave e mbesave dhe të të gjithë Jasharajve të Prekazit. Bile edhe me zjjarrin e shpirtit e të trupit të dajës tim, Osman Gecit, do t'i ngroh.
VDEKJA II: Mos u mundo ta imitosh Prometeun, atë budallanë e madh.
ADEMI: S'kam nevojë të imitoj askë! As Prometeun e Lashtë e as Tahir Mehën e ri! Punën time vetë e di!
VDEKJA II: Flijim i kot!
ADEMI: Të duket ty, po e vërteta është tjetër…
VDEKJA II: E vërteta është se atyre u duhet zjarri dhe flijimi Yt. Po, ty të gjallë nuk të duan.
ADEMI: S'është ashtu siç thua ti!
VDEKJA II: Mëso nga paraardhësi yt, Prometeu.
ADEMI: Pikërisht nga ai kam mësuar.
VDEKJA II: Nuk ke mësuar asgjë nga ai. Ai mbylli të gjitha të ligat e kësaj bote në një kuti, po kunata e tij Pandora e hapi atë dhe të ligat përsëri e pushtuan botën. Ai u solli zjarrin njerëzve, të cilët pasi e ngrohën prapanicën e tyre, i harruan vuajtjet dhe dhembjet e tij, ndërsa, kur më në fund u lirua nga hekurat dhe vuajtjet, filluan ta akuzojnë për shumë gjëra të dyshimta. Kështu do të ndodhë edhe me ty dhe tërë familjen tënde.

ADEMI: Përkundrazi, nga Prometeu kam mësuar se vetëm heronjtë e kanë forcën për të kundërshtuar ligjet e çdo autoriteti sundues, veçan kur është pushtues dhe ky kundërshtim i tyre nuk është ndonjë mëkat, por është virtyti më i lartë, që dëshmon dashurinë e heronjve ndaj njerëzve dhe jetës ë tyre, për të cilën edhe flijohen në forma të ndryshme, por gjithmonë të lavdishme.
VDEKJA II: Ç'u duhet lavdia heronjve të vdekur apo të vrarë e shpeshherë edhe të pavarrosur.
ADEMI: Po shihet se nuk je në gjendje të dalësh nga burgu i egocentrizmit tënd prej të cilit e ke sulmuar jetën.
VDEKJA II: Nuk e di a e sheh ti vrapin e njerëzve për të rrëmbyer sa më shumë të mira materiale? Ata çdo gjë kanë dëshirë ta mbajnë për vete e jo ta ndajnë me të tjerët. Atyre nuk u vjen turp të thonë se janë aq sa kanë. Ata ua kanë zili atyre që kanë më shumë, ndërsa u frikësohen atyre që nuk kanë apo kanë më pak se ata. Natyra e njeriut është egoiste e lakmitare. A ia vlen të flijohesh për ta, o Adem Jashari?!
ADEMI: Njeriu duhet ta ndryshojë vetveten rrënjësisht, nëse do të mbijetojë në këtë botë. Veprimet e tij shpeshherë çojnë ujë në mullirin e shkatërrimit të saj.
VDEKJA II: Nëse i di këto gjëra, pse nuk shikon interesat e tua dhe të familjes sate, po rrezikon çdo gjë?!
ADEMI: Kjo do të ishte jetë miu…
VDEKJA II: Mos e merr me ngut!
ADEMI: Askush në këtë botë, pos të çmendurve, nuk rri duarkryq, kur i rrezikohet e qenmja. Na i kanë marrë të gjitha gjërat dhe këtë e kanë shpallur fitore të tyre, të arsyetuar gjoja me njëfarë të drejte historike. Zhurma ishte dhe është e madhe. Vetëm një gjë as nuk e ditën as nuk do ta dinë edhe një kohë të gjatë: Idealin tonë për të ekzistuar as nuk mund të na e marrin, as nuk mund të na e vrasin, edhe kur na qëllojnë me plumba e predha kalibrash të mëdhenj dhe fytyrën tënde gjakatare, o vdekje, e kanë.
VDEKJA II: Do t'ju vras e do t'ju djeg!
ADEMI: Edhe kur të na djegësh bashkë me shtëpitë tona, nga hiri ynë do të na ringjallë ky ideal dhe do të na bëjë më të fortë.
VDEKJA II: Pas të ashtuquajturës ringjallje, a do të ma dallosh fytyrën time, të cilën bota e modës mund ta shpallë fytyrë të MISS BUKURISË?

ADEMI: Fytyra jote do të digjet nga zjarri i flijimit tim dhe familjes sime! Ajo do të nxihet përjetësisht nga tymi i atij zjarri. Bota mund ta shpallë fytyrë të MIS SHËMTISË!
VDEKJA II: Prite ndëshkimin tim!
HAMZA: Po na gjuajnë me artileri të rëndë!
SHABANI: Po dridhet tokë e qiell, po armët tona s'guxojnë të dridhen!
ADEMI: Oj Kosovë, mos thuaj marova, se djemtë tu ende janë gjallë…

AKTI I KATËRT

VDEKJA E BUKUR: Po bën luftë me një ushtri
që në Prekaz po do me hy!
ADEMI: Derisa kombet të udhëhiqen nga lakmia dhe pangopëshmëria do të ketë lufta! Ne shqiptarët e kemi provuar dhe po e provojmë në kurrizin tonë lakminë dhe pangopësinë serbe, e cila s'njeh asnjë kufi!
VDEKJA E BUKUR: Plumbi në ballë lulen e gjakut ta paska qëndisur.
ADEMI: Lulja në ballë e bukur është.
VDEKJA E BUKUR: Unë të shoh në njerëzishmërinë tënde individuale e në të njëjtën kohë edhe në atë universale, prandaj e di se çka mund të bësh dhe profetizimi im është i pagabueshëm.
ADEMI: Dhe profetizimi yt, thua se mund të jet historia?
VDEKJA E BUKUR: Historia s'është asgjë tjetër, pos njeriu lufton dhunën, shtypjen, shfrytëzimin e njeriut mbi njeriun apo të një populli mbi popullin tjetër, pra është njeriu që mbron të drejtën për të jetuar dhe sulmon vdekjen e padenjë.
ADEMI: Vdekja e Bukur është pjesë e bukur e jetës dhe e mbron gjithmonë atë, duke e bërë më të dashur e më fisnike.
VDEKJA E BUKUR: Po unë a të dukem e bukur?
ADEMI: Në malet e fushat e Drenicës kam parë lule aq të bukura, saqë çdokush i mahnitur nga bukuria do t'i këputste për t'u marrë erë, apo thjesht për t'i pasur pronë. Kurrë nuk më ka shkuar mendja t'i këpus, sepse kjo do të thoshte vrasje e tyre. Pikërisht këtu, i ka rrënjët konflikti im me qizmet serbe që kanë guxuar t'i shkelin lulet më të rralla nga bukuria dhe era e këndshme, motrat e mia të dashura, bijat e denja të LIRISE.
VDEKJA E BUKUR: Nuk m'u përgjigje drejtpërdrejt në pyetje!
ADEMI: Megjithatë, besoj se e ke kuptuar mendimin tim për Ty.

VDEKJA E BUKUR: Nëse tërthorazi e pranon se jam e bukur, a mund ta pranosh drejtpërdrejt se më dashuron?
ADEMI: Dashuria mund të jetë Perëndeshë! Ajo s'mund të jetë pronë e askujt! Ajo mund të ndjehet e të përjetohet! Ajo mund të jetë frymëzim për vepra të mëdha, të cilat mund ta shpëjtojnë jetën e pafajshme njerëzore të vënë në karrigen e të akuzuarit.
VDEKJA E BUKUR: Përgjigjmu thjesht! Më do apo s'më do?
ADEMI: PO, TË DUA !
VDEKJA E BUKUR: Po t'i mbyll sytë me duart e mia të buta, ty, të dashurit tim, Adem Shaban Jashari!

EPILOGU

FEHMI LLADROVCI: Megjithatë, arritëm në Prekaz!
XHEVA: Ja varret ku janë!
FEHMI LLADROVCI: Luan Haradinaj mungon! Ai mbeti në mesin e rrugës, për t'u treguar rrugën për në Prekaz, pelegrinëve që do të vijnë të dashuruar në Vdekjen e Bukur.
XHEVA: Megjithatë, na porositi ta vëmë nga një lule në secilin varr!
ILJAZ KODRA: Nënë e kishit Drenicën
vëlla e kishit diellin e shpresës sonë
baba e kishit qiellin
që s'ishte gjë tjetër
pos një sy gjigant i Shaban Jasharit…
FEHMI LLADROVCI: Drenica ju rriti
deri në lartësinë e flijimit
ju e rritët atë
deri në lartësinë e adhurimit…
BEKIM BERISHA: Nuk e di
a ju ushqeu ju Miti për Prometeun
apo ju e ushqyet Mitin për heronjtë?
XHEVA: (Xheva para varrit të Hamzës)
Nuk e di
sa gryka topash ke mbyllur
sa koka djajsh ke këputur?
FEHMI LLADROVCI: (Para varrit të Ademit)
Nuk e di në cilin varg t'u këput kënga
në cilin tel të çiftelisë t'u ndal tingulli
në cilin trung lisi të mbet shikimi
në cilin yll të shkoi shkëlqimi…

BEKIM BERISHA: Nuk e di
a e ke ditur se Besarta
e mbijetoi Golgotën e Prekazit
e si Marathonomake kumtin na e dha?
TË GJITHË: Vetëm një gjë e dimë me siguri
se Fundi juaj
është një Fillim i Ri
dhe se Perëndesha e juaj ishte
Vdekja e Bukur.
VDEKJA E BUKUR: Në këto varre janë eshtrat
e ëndrrave tuaja për lirinë
kur liria
fytyrë të paprekshme kishte...
ORAKULLI I DARDANISË: Flokët e blertë të tokës janë thinjur
Bari i blertë i kokave njerëzore është tharë
Vetëm pema e dhembjes ka mbirë
E po rritet me shpejtësi rrufeje...
Peizazhin e dhembjes e ndriçon hana
E largët, cinike e ftohtë
Hienat edhe hënën e gjuajnë
me artileri të rëndë...
VDEKJA E BUKUR: Hirësi, unë këtu jam! Adem Jashari më solli!
ORAKULLI I DARDANISË: Ata që mësojnë Artin e Vdekjes
edhe Artin e të Jetuarit
e kanë mësuar
përfundimisht mirë...
FEHMI LLADROVCI: Zëri yt, Hirësi
bie erë përjetësie...
XHEVA: Vdekje e Bukur, o Hyjneshë,
natë e ditë ti rrezaton
me të shtrenjtat rreze dashurie
në shpirtërat tanë ëndërrimtarë...
ORAKULLI I DARDANISË: U qoftë i lehtë dheu dardan
juve stërnipave të Orfeut
nga Vendenisi
juve stërnipave
të mbrojtësve të Trojës
nga okupimi, poshtërimi, lavrimi…

Dardania e vrau frikën
e mbjellë pabesisht
në zemrën e saj
nga djajtë shpëtimtarë,
të shenjtëruar në faltoren e trupit...
U qoftë i lehtë dheu dardan
juve që u niset për ta sjellë
Diellin e Lirisë
Në qiellin e atdheut...
U qoftë i lehtë dheu!

©Ndalohet kopjimi dhe shumëzimi i dramës - pa lejen e autorit dhe të Pashtriku.org.

- FUND -

KUSH ËSHTË KDRUSH RADOGOSHI

Kadrush Radogoshi lindi më 15 Shtator 1948 në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Gjakovë, ndërsa Fakultetin Filozofik (Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe) e kreu në Prishtinë, ku i kreu edhe studimet pasuniversitare të letërsisë dhe mori gradën "Magjistër i shkencave filologjike" duke mbrojtur tezën "Poetika e romanit bashkëkohor shqiptar me tematikë të shekullit të XV".
Prej vitit 1969 e deri në vitin 1981 punoi në arsim, kur e burgosën dhe e akuzuan në bazë të nenit famëkeq 133 alinea 1 të Ligjit penal të ish

Jugosllavisë për vepër penale "propagandë armiqsore", që nënkuptonte sankcionim të lirisë së mendimit dhe fjalës së lirë.

Pas daljes nga burgu u ekskomunikua dhe iu mor e drejta e ushtrimit të profesionit të profesorit për 18 vjet me rradhë. Persekutimi i tij politik nga burokracia politike e Gjakovës shpesh herë mori përmasat e linçit publik. Ishte fajtori kujdestar politik në Gjakovë. Argumenti më domethënës për këtë është fakti se ishte i vetmi gjakovar në mesin e 237 izolantëve shqiptarë, kryesisht intelektualë, të arrestuar më 28 Mars 1989 e të dërguar fillimisht në Burgun e Leskovcit e pastaj të shpërndarë nëpër burgjet tjera të Sërbisë. Në rastin konkret Kadrushi u dërgua në Burgun e Prokuples. Motivacioni i këtij arrestimi ishte dyshimi se këta intelektualë, të cilët ishin shquar në kundërshtimin e rrënimit të autonomisë së Kosovës, mund të ishin të rrezikshëm për rendin kushtetues të ish Jugosllavisë. Ky arrestim nuk ishte bërë me ndonjë vendim gjykate, por me vendim policie të sugjeruar nga komitetet komunale të Lidhjes së Komunistëve të ish Jugosllavisë.

Duke qenë "i papërshtatshëm moralo-politikisht" për "sistemin e vetqeverisjes socialiste jugosllave" qe i papërshtashëm për t'u pranuar në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës nga viti 1981 gjer në vitin 1990. I tillë ishte edhe për redaktorët e të vetmes Shtëpi Botuese "Rilindja" (Libri i tij "Nekrologji për Sodomën" u censurua 7 vjet me radhë). I papërshtatshëm "moralo-politikisht" ishte edhe për dy tre hartuesit e antologjive, të cilët e kishin monopolizuar të drejtën për hartimin e antologjive me pëkrahjen direkte të politikës.

Në vitet 90 të shekullit XX ishte njëri ndër themeluesit e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe njëri ndër udhëheqësit e tyre, në mesin e të cilëve pos Prof.Dr. Hajrullah Goranit ishin edhe Hamëz Jashari (hero i kombit), Agim Hajrizi (dëshmor i kombit) e shumë të tjerë. Në vitet 1992 - 1997 ishte kryetar i Klubit Letrar "Gjon Nikollë Kazazi" të Gjakovës. Gjithashtu ka qenë redaktor i Revistës letrare "Shtigje" të botuar nga ky klub.

Ka shkruar poezi, prozë (tregime dhe romane), dramë, ese, kritikë letrare, artikuj studimorë për letërsinë dhe publicistikë. Ka fituar shumë çmime letrare për poezi e tregim në konkurset letrare të gazetave dhe revistave letrare të Kosovës. Në vitin 2003, me librin "Nëpër universin letrar" fitoi Çmimin "Pjetër Bogdani", i cili jepej për veprën më të mirë letrare të botuar gjatë vitit në Kosovë. Në vitin 2004 fitoi Çmimin Special të Festivalit "Sofra poetike Ymer Elshani",

ndërsa në vitin 2009 me librin poetik "Çabrat Antologjia" fitoi Çmimin për libër më të mirë poetik në Kosovë të botuar brenda dy Mitingjeve poetike, që mbaheshin në Gjakovë.

Deri tash ka botuar 15 libra letrarë të zhanreve të ndryshme letrare. Vlerat e veçanta të krijimtarisë letrare të Kadrush Radogoshit i kanë vënë në spikamë këta shkrimtarë, kritikë e studiues të letërsisë: Akademik Prof.Dr.Pajazit Nushi, Abdullah Konushevci, Rushit Ramabaja, Dr.Arben Hoxha, Mr.Sci.Hajdar Salihu, Mr.Sci.Kadri Rexha, Vasil Vasili, Prend Buzhala, Ismail Syla, Pal Ndrecaj etj. Për vlerat e veprimtarisë letrare të këtij autori, në letra të veçanta dërguar autorit, janë shprehur edhe dy personalitete të veçanta: Ismail Kadare dhe Ukshin Hoti. Disa poezi të tij janë përkthyer në gjuhën angleze, suedeze, romune.

Në periudhën mars 2005 - mars 2007 ishte nënkryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ndërsa në periudhën mars 2007 - mars 2009 ishte kryetar i saj. Në këtë periudhë, si përfaqsues i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ishte anëtar i Këshillit të Librit (organ profesional) në Ministrinë e Kulturës së Kosovës.

I zhgënjyer me rrjedhat negative në Kosovën e pasluftës, së bashku me familje, emigroi në Kanada (në vitin 2010)

* * *

KADRUSH RADOGOSHI

Kadrush Radogoshi was born in Gjakova (a city in the Western Kosova). He completed the primary school, the secondary school and the Teachers' College in Gjakova, whereas the Faculty of Philosophy in Prishtina, where he also completed the postgraduate studies and received the Master of Arts in literature.

From 1969 to 1981 he worked as a teacher, when he was imprisoned and accused based on section 133 of the Criminal Law of the former Yugoslavia, a section against freedom of speech. On March 28, as Kosova's nascent autonomy was effectively revoked by Serbian leader Slobodan Milosevic, Kadrush Radogoshi was one of 237 Albanian intellectuals roundet up and imprisoned, initially in Leskovac prison and then placed in the prisons overall Serbia, in the concrete case, in the prison of Prokuplje. Justification:They were hypothetically dangerous in the political aspect. He was for many years unemployed and politically persecuted, sometimes even up to a public lynching.

After the last war in Kosovo/a (1998-1999) he worked as a literature professor until September 1, 2010, when he emigrated to Canada along with his family. He was vice-president (2005-2007) and president (2007-2009) to the Writers Union of Kosova.

He has published poems, prose (short stories and novels), a drama, essays,and literary criticism. He is the winner of many literary prizes and awards in his country.

He has published the following boks:Between the Silence and the Song,(poems,1981),On theCrossroad (poems,1984), The Poetics of Albanian Contemporary novels, 1985, Necrology for Sodom (poems 1991), Artistic Life of Bereaved Ilir (novel 1993), Interpretations (literary criticism,1993) , Heraldry of Sorrow (poems 1997), Homo Dardanicus (novel 2000), Adem Jashari and Death (drama 2001), Throguh the Literary Universe (literary criticism 2003, "Pjetër Bogdani" Prize, the highest prize for literature in Kosovo), The Roof of Soul Is Leaking, (poems 2004, Special prize of "Poetic table Y. Elshani" 2004), Orpheus From Vendenis (poems, 2005), Through the Circles of Serb Hell (nonfiction, 2005), Award of Publik Library in Gjakova, Smiling Sorrow (poems, 2006), Semantics Of the Other Bank (literary criticism, 2008 - The Best Book "Pegasi" Gjirokastër, Albania), "Çabrat Anthology - A Devout Session (poems, 2008, Prize The Best Poetry Book in Kosovo, in 2009).

Kadrush Radogoshi's books have been comented upon and have been the subject of literary criticism by several literary critics,writers and scholars of literature, among them are: Ph.D.Pajazit Nushi, Ph.D.Arben Hoxha, H.Salihu, A.Konushevci, R.Ramabaja, K.Rexha, Vasil Vasili, Prend Buzhala, Flori Bruci, Pal Ndrecaj etc. His poems were included in several anthologies,also translated into Swedish, Rumanian etc.

"Now,after so many years fighting against censorship and tyranny in Kosovo, Radogoshi is ready to try something new in Edmonton" (Michael Hingston, Edmonton Journal, November 15, 2013).

Radogoshi is a member of this year's Border Writer Circle, through which he appeard as a part at this year's LitFest. He also is a member of Writers Guild of Alberta and a member of Stroll of Poets in Edmonton.

© Pashtriku.org, dhjetor 2013